



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

**ZYRA E KRYETARIT**

**Nr.02-112/13-31140/20**

**Podujevë,**

**Më:26.06.2020**

**SHPALLJE PUBLIKE**

**Për angazhimin e punëtorëve me Kontratë për Punë dhe Detyra Specifike  
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)**

Komuna e Podujevës bën Shpallje Publike duke u bazuar në LIGJIN Nr. 03/L-212 të Punës, Neni 10 dhe kërkesës së Drejtorive, të cila përmes Kontratës për Punë dhe Detyra Specifike kërkojnë angazhimin e punëtorëve për ofrimin e shërbimeve të veçanta për nevojat e tyre.

**Kohëzgjatja e Kontratës për Punë dhe Detyra Specifike është 4 (katër) muaj**

**I.Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

**Pozita: Roje Pylli - Një (1) pozitë**

**Paga: 300 Euro Bruto**

**Kualifikimi: Diplomë e Shkollës së Mesme**

**Përshkrimi i detyrave të punës :**

- Ruajtja e pyjeve nga shfrytëzimi ilegal, dëmtimi, shktërrimi dhe format tjera të shfrytëzimit ilegal të pyjeve dhe tokave pyjore
- Mbrojtja e pyjeve nga zjarri, dëmtuesit dhe sëmundjet me origjinë fitopatologjike dhe entomologjike
- Të parandalojë gjuetinë ilegale, të përkujdeset mbi mbrojtjen e kafshëve të egra si dhe mbrojtjen e objekteve në terrenet e gjuetisë,
- Të kryej procedurën e qarkullimit të masës drusore dhe kontrollimin e transportit të prodhimeve drusore dhe jo drusore të pyjeve,
- Të ndalojë kullotjen ilegale, dëmtimet nga kullotja, nxjerrjen e gurëve, zhavorit, rërës, dheut dhe deponimeve, mbeturinave në pyje pa lejen e organit përgjegjës,
- Të bëjë fletëparaqitje për veprimet ilegale të prerjes, nxjerrje, grumbullimit, përpunimit të materialit drunor dhe jo drunor dhe të njëjtat ti dërgojë në Gjykatat kompetente,
- Të konstatojë identitetin e personit i cili ka shkaktuar dëmin në bazë të letërnjoftimit apo dokumentet tjera përkatëse, gjësendet me të cilat ka kryer veprën, përkohsisht ta konfiskoi masën drusore të prerë dhe mjetin transportues derisa të përfundon procedura gjyqësore,
- Rregullisht dhe në mënyrë të saktë të mbajë ditarin e punës dhe librin e trungjeve,

- Të kontrollojë shfrytëzimin e pyjeve në ngastrat e lejuara për shfrytëzim në pyjet publike,
- Të bëjë zëvendësimin e rojtarit tjetër gjatë kohës së pushimit vjetor

## **II.Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit**

**Pozita: Zjarrfikës - Një (1) pozitë**

**Paga: 350 Euro Bruto**

**Kualifikimi: Diplomë e Shkollës së Mesme**

### **Përshkrimi i detyrave të punës :**

- Merr pjesë në shuarjen e zjarreve dhe në të gjitha llojet e emergjencave dhe kryerjen e aktiviteteve .
- Kujdestaron në ndërrimin e vetë,
- Kujdeset për pajisjet e veta personale dhe të përbashkëta ,
- Kujdeset për mirëmbajtjen e stacionit të zjarrfikësve,
- Kujdeset për mirëmbajtjen e automjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse,
- Punon me ndërrime me uniformë në gjendje gatishmërie gjatë orarit të punës dhe jashtë orarit të punës në rast nevojë.

## **III.Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit**

**Pozita: Zjarrfikës -Vozitës - Një (1) pozitë**

**Paga: 350 Euro Bruto**

**Kualifikimi: Diplomë e Shkollës së Mesme, Patent Shofer - Kategoria C**

### **Përshkrimi i detyrave të Punës:**

- Drejton automjetin, kujdeset për të dhe e mirëmbanë, manipulon gjatë intervenimit, ushtrimeve dhe në raste tjera kur është nevoja,
- Kujdeset edhe për pajisje tjera (pompa motorike, shkallët, gjenerator, ... etj)
- Merr pjesë në fikjen e zjarrit dhe shpëtimit të njerëzve dhe të mirave materiale të rrezikuara nga zjarri,
- Përgjigjet thirrjes në raste të intervenimit në fikjen e zjarrit dhe tjera Intervenime edhe kur është në detyrë,
- Rregullisht vijon trajnimet dhe kurset nga lëmia e zjarrfikëjes:
- I kryen të gjitha urdhëresat e udhëheqësit të ndërrimit ose Shefit të Shërbimit përveç atyre urdhëresave të cilat të kryera do të ishin vepër Kundërvajtje ose penale,

## INFORMATË PËR TË GJITHË APLIKANTËT

### Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- CV
- Certifikaten qe ndaj tij nuk jane duke u zhvilluar hetime
- Kopjen e leternjoftimit
- Kopjen e Dokumentacionit per kualifikimin e kërkuar

### Data e shpalljes : 26.06.2020 deri më 30.06.2020

Komuna e Podujevës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur **5 ditë** nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik dhe në tabelën e shpalljeve

Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë.



Nënkryetari i Komunës  
Nexhmi Rudari